




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2026

Drejtori: Ardian kavaja

MARS 2026

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME

- I. HYRJE
- II. DREJTORIA
- III. STAFI I DREJTORISË
- IV. SEKTORI I PLANIFIKIMIT
- V. SEKTORI I URBANIZMIT
- VI. SEKTORI I LEGALIZIMI
- VII. SEKTORI I BANIMIT DHE
- VIII ZYRTARI LIGJORË

I. HYRJE

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM, NË BAZË TË ORGANOGRAMIT AKTUALISHT FUNKSIONON ME KATËR SEKTORË:

- 1. SEKTORI PËR PLANIFIKIM**
- 2. SEKTORI PËR URBANIZMËM**
- 3. SEKTORI PËR LEGALIZIM**
- 4. SEKTORI PËR BANIM DHE**

Dhe po ashtu në Kuadër të stafit të Drejtorisë ekziston Zyrtari Ligjorë

Kjo Drejtori me stafin e saj janë të obliguar të ndërmarrin hapat dhe veprimet procedurale, konform përgjegjësive për realizimin e objektivave të parapara sipas Plan-Programit të saj, me qëllim të inkorporimit dhe arritjes së strategjisë si dhe të objektivave të Planit, gjithnjë duke u bazuar në rregullativen ligjore, siq janë:

- Ligji për Ndërtimin nr.04/L-110
- Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174
- Ligji për Financimin e Programeve të veqanta të Banimit nr.03/L-164
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040
- Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031
- Aktet nënligjore, Udhëzimet Administrative
- Rregulloret Komunale, si dhe
- Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Andaj me qëllim të përcaktimit dhe arritjes së objektivave, Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm, duke vepruar në kuadër të përgjegjësive harton:

PLAN PROGRAMIN E PUNËS PËR VITIN 2026

II. DREJTORIA

DEKLARATA E MISIONIT:

MISIONI PARËSOR I DREJTORISË ËSHTË KRIJIMI I NJË AMBIENTI TË SHËNDOSHË DHE FUNKSIONAL PËR BANIM, PUNË, SPORT, REKREACION, DUKE RESPEKTUAR RREGULLATIVËN EKZISTUESE LIGJORE.

PAS PËRFUNDIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË MIRATUAR PËR PERIUDHËN KOHORE 2020-2028, DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM KA QENËBARTËSE E GJITHË AKTIVITETIT PROCEDURAL ADMINISTRATIV NGA FILLIMI E GJER NË PËRFUNDIMIN E DOKUMENTIT TË PALNIFIKIMIT-HARTËS ZONALE TË KOMUNËS, E CILA SI DOKUMENT ËSHTË FINALIZUAR DHE ËSHTË E ZBATUESHME NGA MUAJI NËNTOR 2025, PËR TË VAZHDUAR ME HARTIMIN E DETYRAT TJERA PROJEKTUESE DHE ME HARTIMIN E PLANEVE TË HOLLËSISHME RREGULLATIVE URBANE., ME IMPLEMENTIMIN E TYRE.

PROCEDON KËRKESA PËR LËSHIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT. KUJDESET PËR DOKUMENTACIONIN INVESTIVO-TEKNIK DHE PËRPUTHSHMËRINË E TIJ ME KUSHTET E DHËNA URBANO-TEKNIKE. LEJON SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE. MBULON SFERËN E BANIMIT. BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME QEVERINË - MINISTRINË E EKONOMISË AMBIENTIT DHE INFRASTRUKTURËS.

III. STAFI I DREJTORISË

Është e domosdoshme të theksohet fakti se, në disa raste na paraqiten vështirësi në arritjen e objektivave gjatë vitit kalendarik të punës, në mungesë të plotësimin të stafit punues me zyrtarë të rinjë e duke qenë se vite me radhë është zvogëluar përbërja e stafit për shkak të pensionimit të ish zyrtarëve. Mirëpo duke i pasur në konsideratë mundësitë e limituara buxhetore për rekrutimin e zyrtarëve të nevojshëm për plotësimin e stafit të Drejtorisë, sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2026, Planifikojmë që do të bëhet plotësimi stafit të Drejtorisë me:

1.Zyrtar/e për Buxhet dhe Financa

1.Zyrtar/e për mbështetje Ligjore

1.Zyrtar/e Administrative

Andaj me qëllim të realizimit të objektivave të parapara me Plan Programin e Drejtorisë dhe detyrave shtesë, është më se e domosdoshme plotësimi i këtyre vendeve të nevojshme të punës gjatë vitit kalendarik 2026, me arsyen reale se është e pamundur të arrijmë rezultatet e duhura dhe të knaqshme, nëse vazhohet mbështetja vetë në personelin- stafin aktual.

IV. SEKTORI I PLANIFIKIMIT

DEKLARATA E MISIONIT:

PASI QË KJO DREJTORI ËSHTË BARTËSE E PËRGJEGJËSISË INSTITUCIONALE NË NIVELIN LOKAL KOMUNAL, PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTËN ZONALE TË KOMUNËS TANI TË MIRATUARA, PËRGJEGJËSIA VAZHDON ME MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E KËTYRE PLANEVE GJATË PROCESIT TË IMPLEMENTIMIT TË TYRE, HARTIMIN E PLANEVE URBANE TË HOLLËSISHME, LËSHIMI I LEJEVE PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE DHE TË SIPËRFAQEVE PUBLIKE, KUJDESET PËR ZBATIMIN E LIGJEVE TË SFERËS SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR, SI: LIGJIT Nr 04/L-174 PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR (LPH), SI DHE TË UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE TË MMPH-SË

IV.1. Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit të Planifikimit:

- 1.1. Do të vazhdohet me procedurat ligjore Implementimin e Hartës Zonale të Komunës
- 1.2. Do të vazhdoj me lëshimin e lejeve, sipas kërkesave për shfrytëzimin e sipërfaqeve dhe hapësirave publike,
- 1.3 Trajnime profesionale të stafit,
- 1.4. Bashkëpunimi me zyrën regjionale të Ministrisë së Ambientit dhe Infrastrukturës
- 1.5. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare,
- 1.6. Përgaditja dhe propozimi i lokacioneve për objekte të karakterit të përgjithshëm,
- 1.8. Hulumtimi i donacioneve të mundshme dhe bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm.

IV.2. Zbërthimi dhe realizimi i objektivave:

- 2.1. Kujdesi gjatë implementimit të dokumentit të Hartës Zonale Komunale.

Punët organizative janë të planifikuara si në:

- Pjesëmarrje në takime me organiza apo OJQ të Arkitektëve për këmbimin e përvojave profesionale.
- Pjesëmarrjen e Grupeve të interesit në proces të hartimit të Dokumenteve të ardhshme të Planifikimit, OJQ, shoqëria civile, Komuniteti i Biznesit etj.
- Sensibilizimin përmes mediave për procesin e hartimit të Dokumenteve të ardhme të Planifikimit në zonat të cilat I ka përcaktuar Harta Zonale Komunale.

IV.3. Lejet për shfrytëzimin e sipërfaqeve dhe hapësira publike:

Duke u nisur nga fakti se, ky Sektor pranon në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të kërkesave për leje për shfrytëzimin e sipërfaqeve dhe hapësirave publike, të cilat procedohen sipas Rregullores Komunale Nr. 01/2023, për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike, ndërsa për Dhënien në Shfrytëzim të objekteve apo lokaleve në pronësi të

Komunës, procedohet sipas Rregullores Komunale Nr. 03/2022, Për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se 1 (një) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

IV.4. Trajnimet e stafit profesional:

Planifikojmë trajnimin e Planerëve në fushën e aplikimit të GIS-it (Sistemi Gjeografik Ndërkombëtar), të mbështetur nga nivele të ndryshme: nacionale, regjionale, komunale, lokale, etj., gjithnjë duke e angazhuar një profesionist të kësaj lëmieje me një vendim të përhershëm, e në pamundësi, alternativë do të jetë angazhimi i përkohshëm.

GIS-i poashtu shërben për interpretimin e shumanshëm të të dhënave në forma dhe formate të ndryshme dhe racionalizon (kursen) kohën deri në 40% në raport me aplikimin e programeve tjera.

Kërkesat tona do jenë të parashtruara me shkrim zyrtarëve të MMPH-së, dhe Institutit për Planifikim dhe zotimet të tyre, e tëra kjo duke u bazuar në rezultatet dhe reagimet e anketës mbi përdorimin dhe zhvillimin e Programit Softverik të GIS-it, ku do të bëhet pregaditja e inventarit dhe raportimit i cili do të shërbej për të siguruar të gjitha informatat relevante, të specifikojë aktivitetet dhe të ofroj rekomandime për zhvillimet e mëtutjeshme në sistemin e informacioneve të bazuar në GIS.

IV.5. Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit Ekonimisë dhe Infrastrukturës:

Bashkëpunimi me MAEI-në kryesisht është përqëndruar në dhënjen e raporteve të ndryshme dhe informative, nga aspekti i situatës urbane dhe të dhënave rreth profileve të ndryshme të qytetit sipas nevojës që MAEI-ja i sheh të arsyeshme dhe i kërkon. Këtu duhet veçuar obligimet tona si Komunë me dërgimin e të gjitha Planeve Hapësinore (Hartës Zonale Komunale, Planit Rregullues të Hollësishëm) në formatet digjitale dhe tekstuale si dhe nevojat tona për ndihmesën nga MAEI për Hartën Zonale. (me punëtori dhe trajnime).

IV.6. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare:

Bashkëpunimi me këto institucione janë çështjet e përgjithshme dhe modalitete të natyrave të ndryshme. Kryesisht në aspektin e Donacioneve si dhe trajnimeve dhe punëtorive në fusha të ndryshme.

IV.7. Përgaditja dhe propozimi i lokacioneve për objekte të karakterit të përgjithshëm:

Pas miratimit dhe fuqizimit të Planit Zhvillimor Komunal , mbetet obligim i planifikuar që konform nevojave të parashtruara të shqyrtojmë dhe hartojmë edhe propozimin e lokacioneve për objektet e infrastruktures Publike: arsimore, shëndetësore, sportive, në mënyrë që pastaj sipas anës procedurale përmes hallkave institucionale të aprovohen.

Me finalizimin e Hartës Zonale , do të zgjerohen mundësitë për dhënien e pëlqimeve për lokacione dhe mikrolokacione edhe për nevoja të tjera, dhe ngritet efikasiteti i këtij sektori në

përmbushjen e obligimeve ndaj kërkesave të shumëta të qytetarëve (Investitorëve potencial) që do të ndikonin edhe në zbatimin e PZHK-së.

IV.8. Hulumtimi i donacioneve të mundëshme dhe bashkëpunimi me donatorë:

Pas miratimit nga Asambleja Komunale e Hartës Zonale, si dhe aprovimit nga ana e MAEI-së, planifikojmë të aplikojmë për donacione dhe investime të mundshme tek organizmat kombëtar dhe ndërkombëtar që ndërlidhen me sferat e interesit të përgjithshëm të shoqërisë në fushat: Shëndetësi, Arsim, Agrokulturë, Mbrojtje të Ambientit, Infrastrukturorë, etj.

V. SEKTORI I URBANIZMIT

DEKLARATA E MISIONIT:

DO TË VAZHDOHET ME LËSHIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT KONFORM RREGULLATIVAVE EKZISTUESE, KONTROLLIMIN E DOKUMENTACIONEVE INVESTIVO-TEKNIKE, SHFRYTËZIMIN E SIPËRFAQEVE PUBLIKE NË PËRPUTHJE ME RREGULLORET DHE REALIZIMIN E MJETEVE FINANCIARE, DUKE PARAQITUR SHTYLLËN KRYESORE TË TË HYRAVE VETANAKE NË BUXHETIN KOMUNAL.

V.1. Planifikimi dhe objektivat gjenerale të sektorit të urbanizmit:

- 1.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në implementimin e Hartës Zonale Komunale.
- 1.2. Shqyrtimi i kërkesave dhe udhëheqja e procedurës complete për Leje të Ndërtimit,
- 1.3. Vazhdimi i procedurës për pajisje me leje ndërtimi për objektet e ndërtuarara nga donatorë të mundshëm.

V. 2. Zbërthimi dhe realizimi i objektivave:

2.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në hartimin e planeve të Hollsishme Rregulluese urbane.

Sektori i Urbanizmit, gjatë aplikimit të procedurave për lëshimin e lejeve të ndërtimit do të kujdeset për harmonizimin e kërkesave me Hartën Zonale të Komunës në situatat ku kërkohet dhënia e kushteve të ndërtimit.

2.2. Shqyrtimi i kërkesave dhe udhëheqja e procedurës complete për Leje Ndërtimi:

Edhe përkundër aktiviteteve të shumta të cilat na presin, planifikojmë që shqyrtimi i kërkesave për leje të ndërtimit të shqyrtohen me kohë dhe lëshimi i lejeve të ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II-të të përfundohet brenda afatit të paraparë ligjorë për lëshimin e tyre.

2.3. Vazhdimi i procedurës për paisje me leje ndërtimi dhe shërbime tjera, për objektet me donacion nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtar si dhe me bashkëfinancim:

2.4. MKRS në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm do të bashkëpunojë në të gjitha procedurat për Leje Ndërtimore dhe për objektet të cilat i financon MKRS.

VI. I LEGALIZIMI

Trajtimi i Ndërtimeve Pa Leje – Legalizimet:

Edhe gjatë periudhës së vitit kalendarik 2026, do të procedohet në shqyrtimin e vazhdueshëm të një numri të konsiderueshëm të kërkesave për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, dhe presim që të gjitha kërkesat e parashtruara të marrin përgjigje në pajtueshmëri me Ligjin e aplikueshëm dhe udhëzimet Administrative, ndërsa ato kërkesa të cilat mbesin në listë të pritjes do të përfundohen sipas udhëzimeve të Ministrisë përkatëse, e ato raste janë kur nuk është zgjidhur çështja pronësore për parcelat ndërtimore.

Vendimet merren varësisht nga gjendja aktuale e ndërtimeve pa leje (të përfunduara, të papërfunduara), shtrirjen e objekteve në hapsirë afër (zonave të mbrojtura, në toka bujqësore nën komasacion, në prona komunale, shoqërore, infrastrukture), plotësimin e dokumentacioneve të pa kompletuara.

Për të gjitha Vendimet në Listën e Pritjes do të mirren Vendime të reja në kontinuitet në bazë të ofrimit të dëshmive nga palët në bazë të Ligjit në fuqi dhe Udhëzimeve Administrative.

Aktivitetet tjera të Sektorit për Legalizim

- Sektori do të vazhdojë të koordinojë punët me Ministrinë e Infrastrukturas dhe Ambientit në vazhdimësi për Legalizimin e ndërtimeve pa leje në Komunën tonë.
- Do të raportojë në Ministrinë përkatëse sipas kërkesës së tyre siq ka qenë edhe më parë.
- Në vazhdimësi do të pranohen palët për informim për procesin e Legalizimit.
- Udhëzimin e palëve për lidhur me procedurat për legalizimin e ndërtimeve pa leje.
- Do të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë për Gjeodezi Pronë dhe Kadastër.

Do të bashkëpunojë dhe ti përgjigjemi në pyetjet të cilat na parashtrajnë në vazhdimësi rreth procesit të legalizimit nga komuniteti, OJQ-të, Shoqërinë Civile, OSBE, dhe të gjitha palët e interesuara për procesin e Legalizimit.

VII. SEKTORI I BANIMIT

DEKLARATA E MISIONIT:

KRIJON DHE MIRËMBANË DATABAZËN NË SFERËN E BANIMIT, KUJDESET PËR BANESAT DHE HAPËSIRAT AFARISTE NË PRONËSI TË KOMUNËS, PËRMES RREGULLIMIT TË KONTRATAVE PËR SHFRYTËZIMIN E TYRE DHE HARTON PLANPROGRAME DHE PROJEKTE TË FUSHËS SË BANIMIT DHE BANIMIT NË BASHKËPRONËSI.

VII.1. Planifikimi dhe objektivat gjenerale të sektorit të banimit:

- Planifikojmë që të plotësohet ky Sektor me staf profesional për përmbushjen e detyrave të Sektorit.
- Inicimin e procedurave dhe formimin e komisionit për hartimin e Planit Trevjeçar për Banim 2026–2029 dhe hartimi i tij
- Ndërmarrja e veprimeve për rregullimin e shfrytëzimit kontraktual të lokaleve afariste komunale sipas Rregullores në fuqi
- Implementimi i projektit të banimit social adekuat përmes Njësitit, koordinimi i aktiviteteve nga hartimi i projektit me kontraktuesin e deri në dokumentacion teknik
- Inicimi i procedurave të tenderimit për ndërtimin e objekteve të banimit social
- Inicimin e procedurave për formimi i komisionit për vlerësim dhe verifikim të gjendjes sociale dhe ekonomike të familjeve në banesat sociale nga Kuvendi Komunal
- Ripërtëritja/ndërprerja e kontratave të skaduara për përfituesit e banesave sociale dhe shtëpitë në Frashër duke ju referuar raportit\rekomandimit të vlerësimit të gjendjes ekonomike sociale nga komisioni
- Identifikimi i nevojës për ndryshimin e Rregullores për taksat, tarifat dhe gjobat komunale, propozim-ndryshimeve për çmimoren për m² taksat për dhënjën me qira të objekteve dhe lokaleve prone/menaxhim komunale
- Evidentimi dhe përditësimi i të dhënave për shfrytëzuesit e lokaleve afariste komunale që do të kontraktohen në 2026 si dhe banesave dhe shtëpive të cilave do t'ju ripërtrihen kontratat me komunën për qera joprofitabile
- Shqyrtimi i projektit dhe listës kontrolluese për leje ndërtimore për kategorinë II , pika X. Normat minimale teknike të banimit në bashkëpronësi
- Shqyrtimin e kërkesave për çështje të banimit
- Punën në vazhdimësi në komisionet të emëruara në nivel komunal
- Përgatitja e raporteve periodike për punët në sektorin e banimit
- Bashkëpunimi dhe takime të vazhdueshme me MMPHI, DMS, dhe sektorët ndërinstitucional

Aktivitet Finaciare dhe planifikimi i Buxhetit për vitin 2026

Planifikimi i Buxhetit të Drejtorisë si dhe angazhimi për realizimin e tij.

Për vitin 2026 është parashikuar realizimi i të hyrave buxhetore si vijon:

• Taksa për Leje të Ndërtimit.....	1,000,000,00
• Taksa për ndërrim të Destinimit të Tokës ...	34,516.76
• Legalizimi i objekteve	47,133.54
• Taksa për reklama	10,000.00
• Shfrytëzimi i hapësirave publike.....	50,000.00
• Qeraja nga prona Publike	2,500.00
• Totali i të hyrave për këtë periudhë:	1,141,662.8 €

VIII. ZYRTARI LIGJORË

VIII.1. Bazuar në përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave të punës si dhe sipas Organogramit të Drejtorisë, është përgjegjës ndaj Drejtorit të Drejtorisë për çështje ligjore dhe procedura administrative.

Për vitin 2026, do të vazhdohet me nxjerrjen e Akteve Administrative, me hartimin e propozim vendimeve sipas nevojave të paraqitura në Drejtori.

Poashtu do të veproj në kontinuitet të plotë për ofrimin e bahskëpunimit në aspektin juridiko-administrativ me stafin e Drejtorisë si dhe me ofrimin e këshillave ligjore sipas nevojës për zgjedhjen e çështjeve juridike administrative.

Do të ndërmer veprime në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive sipas kërkesave të Drejtorit të Drejtorisë, gjithnjë në respektim të plotë të Ligjeve të fuqi dhe akteve tjera nënligjore, Udhëzimeve administrative dhe Rregulloreve Komunale.

Pjesmarrje e vazhdueshme dhe aktive në komisione të ndryshme për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të organeve gjegjëse të Administratës.

IX. AKTIVITETE NDËR SEKTORIALE

IX.1. Mbikëqyrjet profesionale dhe komisionet

Aktivitetet ndërsektoriale është emëruesi i përbashkët për të gjitha detyrat dhe aktivitetet të cilat kërkohen të ndërmerren në bazueshmëri profesionale të stafit të drejtorisë pavarësisht sistemimit të tyre në sektorët përkatës. Këto aktivitete dhe detyra janë të karakterit profesional në cilësi të mbikëqyrjeve të ekzekutimit të punimeve për objektet, investitor i së cilës është Komuna, apo është donacion, në cilësi të anëtarëve të mundshëm në komisione përkatëse.

1.2. Bashkëpunimi me Kompanitë publike: KEDS-i, PTK-ja, Ujësjiellësi Rajonal, "UNITETI", Komform kërkesave të qytetarëve apo subjekteve planifikojmë ngritjen e efikasitetit të shqyrtimit të tyre dhe përgaditjen e përgjigjeve meritore sipas rregullativës ligjore.

PËRFUNDIMI

Krijimi i kushteve për një ambient të shëndoshë për banim, punë, sport, rekreacion dhe ruajtjen e menaxhimin e objekteve Komunale, është misioni parësor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, i cili mund të ndërtohet shumë më lehtë dhe më shpejtë me angazhimin e të gjithë akterëve relevant në të gjitha fazat e planifikimit, përmes gjetjes së strategjisë për veprim.

Drejtori IDPU-së

Ardian Kavaja

